



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2161/1 Prot

Tiranë, më 10/08/2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

**SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE \_\_\_\_\_**  
**DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK \_\_\_\_\_**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr.11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.180 prot, datë 02.09.2020 “Njoftim për vende të lira pune” të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, protokolluar në AKPA me nr.2161 prot, datë 04.09.2020,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale, në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, për pozicionet:

- a) 2 Mësimdhënës të teorisë profesionale në drejtimin Shërbime Mjete Transporti
- b) 1 Mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Elektroteknike e Integruar me Elektronikën

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

## 2.Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 11.09.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionet:

- a) 2 Mësimdhënës të teorisë profesionale në drejtimin Shërbime Mjete Transporti
  - b) 1 Mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Elektroteknike e Integruar me Elektronikën
- në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Elira DEMIRAJ**

